VENDIM
Nr. 208, datë 15.3.2017

PËR KRIJIMIN E MUZEUT KOMBËTAR "GJETHI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, e 12, pika 3, të ligjit nr. 9386, datë 4.3.2005, "Për muzetë", dhe të ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Muzeut Kombëtar "Gjethi", si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. Muzeu Kombëtar "Gjethi" do të ushtrojë veprimtarinë si institucion i specializuar i veçantë, me status "Muze Kombëtar" në fushën arkivore, me seli në qytetin e Tiranës, rruga "4 Shkurti", Tiranë.

3. Muzeu Kombëtar "Gjethi" ka tematikë kryesore përkujtimin e dhunës psikologjike të regjimit komunist e të kontrollit të qytetarëve përmes përgjimeve të kryera nga ish-Sigurimi i Shtetit.

4. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave për krijimin e Muzeut Kombëtar "Gjethi", për vitin 2017, përballohet nga numri i punonjësve dhe buxheti i miratuar, për këtë vit, për Ministrinë e Kulturës.

5. Struktura dhe organika e Muzeut Kombëtar "Gjethi" miratohen me urdhër të Kryeministrit.

6. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Muzeu Kombëtar "Gjethi" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama